



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017 Ref.: 67117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc, 120 ECTS, maksimumi 45 studentë për vit akademik;
- II. Obligohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- III. Obligohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programit të studimit: Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi	MSc	120	Ercan Canhasi, Xhevahir Bajrami, dhe Naim Baftiu

1/2

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" më 16.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Andrew Goodspeed, Dhurata Shehri, Patricia Kotnik, dhe Peeter Normak.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

